



Prishtinë: 27.05.2009
Kodi i ZRRE-së: V_191_2009
Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_205_05_09

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_V_205_05_09;
5. Apelimi i konsumatorit i datës 19.05.2009; dhe
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 27 maj 2009 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Gani Latifi (shifra e konsumatorit DPR – 2002674) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 29.01.2009 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 26.01.2009, lidhur me kontestimin e borxheve në shifra ilegale.

- Me datë 10.07.2007 zyrtarët e autorizuar të shërbimit të kontrollës së KEK-ut kanë dalur tek konsumatori dhe kanë konstatuar se konsumatori është lidhur në rrjetin elektrik të tensionit të ulët pa marrëveshje për kyçje (pa pëlqim elektroenergjetik, ku ka tre njehsor të palajmëruar: nr. 34721270, nr. 34721277, dhe 34721254.
Provë: Procesverbali nr. 00197 të datës 10.07.2007
- Me datë 11.07.2007 konsumatori ka bërë aplikimin për lidhje të re vetëm për njehsorin nr. 34721254.
Provë: Aplikacioni për lidhje të re
- Me datë 25.07.2007 KEK-u ka bërë regjistrimin e njehsorit elektrik me nr. 34721254 ku edhe ka vulosur njehsorin.
Provë: Procesi i pranimit të instalimit elektrik i datës 25.07.2007

- Me datë 04.12.2007 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK.
Provë: Dëftesë ankesa e konsumatorit
- Me datë 26.01.2009 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e kontrollës nr. 00197.
Provë: Përgjigja e KEK-ut
- Me datë 29.01.2009 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK në ZRRE-së
- Me datë 12.05.2009 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit ku ka refuzuar ankesën e konsumatorit lidhur me kontestimin e borxheve në shifrat ilegale.
Provë: Përgjigja e DMK së ZRRE-së e datës 12.05.2009
- Me datë 19.05.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_205_05_09
Provë: Ankesa e konsumatorit

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_205_05_09** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së dhe me kornizën ligjore në fuqi. Apeluasi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente në Prishtinë, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së:

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Dr. Nysret Avdiu, anëtar

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar